



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:115510
Datë: 19.09.2024
Numri i dokumentit: 06184646

C.nr.1758/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË/Departamenti i Përgjithshëm - Divizioni Civil, si gjykatë e shkallës së parë, me gjyqtaren Vlerona Maliqi, në çështjen juridike kontestimore të paditësit Sh. M. nga M., të cilin sipas autorizimit e përfaqëson Valon Mehmeti – avokat nga Mitrovica, kundër të paditurës T. sh.a, me seli në M., me objekt kontesti kompensim i orëve të punës gjatë ditëve të vikendit, në seancën e mbajtur më datë 18.09.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET tërheqja e padisë së paditësit Sh. M. nga M., e ushtruar kundër të paditurës T. sh.a, me seli në M., me objekt kontesti kompensim i orëve të punës gjatë ditëve të vikendit, në këtë çështje juridike kontestimore.

II. Secila palë i bart shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Paditësi Sh. M. nga M., në këtë gjykatë ka ushtruar padi kundër të paditurës T. sh.a, me seli në M., me objekt kontesti kompensim i orëve të punës gjatë ditëve të vikendit.

Lidhur me këtë çështje juridike, duke marrë për bazë vullnetin e palëve ndërgjyqëse për lidhjen e ujdisë gjyqësore, gjykata ka caktuar seancën e shqyrtimit përgatitor, në të cilën përfaqësuesi i

autorizuar i paditësit ka deklaruar se e tërheq padinë e ushtruar në këtë çështje juridike, me arsyetimin se pas parashtrimit të padisë, nga e paditura është njoftuar zyrtarisht se paditësi nuk ka punuar gjatë ditëve të vikendit dhe rrjedhimisht të njëjtit nuk i takon kompesnimi mbi këtë bazë, Shpenzimet e procedurës ka deklaruar se nuk i kërkon.

I autorizuari i të paditurës nuk e ka kundërshtuar tërheqjen e padisë së paditësit. Shpenzimet e procedurës nuk i ka kërkuar.

Në rastin konkret gjykata gjen se me dispozitën e nenit 261 par.3 të Ligjit Nr.03/L-006 për Procedurën Kontestimore (LPK), përcaktohet se: *“Po që se padia është tërhequr, gjykata jep aktvendim me të cilin konstatohet se është tërhequr padia. Ky aktvendim i dërgohet të paditurit vetëm po që se padia i është dorëzuar me parë”*. Andaj duke u bazuar në këtë dispozitë ligjore, gjykata vendosi si në pikën I të dispozitivit të këtij aktvendimi.

Vendimi për shpenzimet e procedurës është marrë në bazë të nenit 450 të LPK-së.

Nga sa u tha më lart, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm/Divizioni Civil
C.nr.1758/2024 më datë 18.09.2024

G j y q t a r j a

Vlerona Maliqi

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa.